



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Ligji Nr. 03/L-065**

**PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR DHE KONTROLLIN E KUFIRIT  
SHTETËROR**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për menaxhim të integruar dhe kontroll të kufirit shtetëror,

Miraton këtë

**LIGJ PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR DHE KONTROLLIN E KUFIRIT  
HTETËROR**

**KREU I**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Fushëveprimi i Ligjit**

1.1 Ky Ligj përcakton autoritetet kompetente dhe përgjegjësitë e tyre për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

1.2 Ky ligj zbatohet pa paragjykim ndaj mandatit të veçantë të organizatave ndërkombëtare, ashtu si parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

1.3 Bashkëpunimi ndërmjet agjencive bëhet nga policia kufitare, Shërbimi Doganor, Shërbimi Fitosanitar, Shërbimi Veterinar, dhe të gjitha agjencitë tjera relevante siç janë të definuara me Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.

1.4 Dispozitat në këtë ligj janë të aplikueshme ndaj të gjithë personave që hynë apo lëshojnë Kosovën me përjashtim të atyre që kërkojnë apo mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme se do të kërkojnë azil. Në raste të tilla, do të aplikohet Ligji mbi Azilin.

**Neni 2**

## Përkufizimet

Për qëllim të këtij Ligji, shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim:

**“Autoritetet Kompetentë”** nënkupton, Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministrinë dhe organet tjera të ngarkuara me përgjegjësinë për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror siç parashihet në Strategjinë e Integruar për Menaxhimin Kombëtar të Kufirit.

**“Zyrtarët e Autorizuar”** nënkupton zyrtarët qeveritarë të Republikës së Kosovës të ngarkuar me përgjegjësinë për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

**“Menaxhimi i integruar i kufirit (MIK)”** nënkupton bashkërendim dhe bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjithë autoriteteve përkatëse dhe agjencive të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë, për vendosjen e sistemeve të efektshme dhe me rendiment të menaxhimit të integruar të kufirit, më qëllim arritjen e objektivit të kufijve të hapur, por të mirë-kontrolluar dhe të sigurt.

**“Vija kufitare”** nënkupton vijën, e cila ndan territorin e Republikës së Kosovës nga territoret e shteteve fqinje.

**“Kufiri shtetëror”** nënkupton kufirin tokësor, ujor, dhe ajror përfshirë aeroportet të cilat zhvillojnë komunikacion ndërkombëtar.

**“Pikat e kalimit kufitar”** nënkupton vendet e identifikuar zyrtarisht ku personat, mallrat dhe pasuritë e tundshme mund të kalojnë kufirin në mënyrë legjitime gjatë orarit të punës.

**“Kufiri i gjelbër”** nënkupton çdo vijë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera me përjashtim të pikave zyrtare të kalimit;

**“Kufiri i Kaltër”** nënkupton çdo hapësirë me ujë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera me përjashtim të pikave zyrtare të kalimit.

**“Kalimi i kufirit shtetëror”** nënkupton të gjitha lëvizjet e njerëzve, mallrave dhe pasurive të tundshme matanë kufirit shtetëror.

**“Pikat e përkohshme të kalimit kufitar”** nënkupton lokacionet e identifikuar zyrtarisht që shërbejnë si pika të kalimit kufitar për një periudhë të caktuar kohore kufitare.

**“Demarkacioni”** nënkupton vijën kufitare ndërmjet dy shteteve fqinje.

**“Kontrolli kufitar”** nënkupton kontrollin e kryer në pikat e kalimit kufitar për të siguruar që personat, mallrat dhe mjetet e tyre të transportit janë të autorizuar të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës apo të lëshojnë Republikën e Kosovës.

**“Zona e kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror”** nënkupton sipërfaqen e identifikuar dhe shënuar zyrtarisht e cila rrethon pikën e kalimit kufitar.

**“Incidentet kufitare”** nënkupton aktivitetet brenda vijës kufitare ose përtej saj, të kryera nga qeveritë e huaja apo zyrtarët e qeverive të huaja dhe të cilat shkelin marrëveshjet ndërkombëtare apo kufirin shtetëror.

**“Kavitetet trupore”** nënkupton hapësirat natyrore ose sinuset brenda trupit në të cilat mund të fshihen gjësendet.

## Neni 3

## **Parimi i proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë**

3.1 Organet Kompetente aplikojnë parimin e proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë si kufizim gjatë ushtrimit të autorizimeve të tyre.

3.2 Forca fizike përdoret vetëm atëherë kur është e domosdoshme, dhe vetëm deri në atë nivel që nevojitet për t'i arritur objektivat ligjore të policisë me pasoja sa më pak të dëmshme dhe për kohë sa më të shkurtër të mundshme.

### **Neni 4**

#### **Qëllimi i menaxhimit të integruar dhe kontrollit të kufirit**

Menaxhimi i integruar dhe kontrolli i kufirit shtetëror bëhet me qëllim të:

- (i) sigurimit të pacenueshmërisë së kufirit shtetëror;
- (ii) mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve;
- (iii) parandalimit dhe zbulimit të veprave penale dhe kundërvajtese, zbulimit dhe arrestimit të kryerësve të tyre;
- (iv) parandalimit, zbulimit dhe ndalimit të migrimit të kundërligjshëm;
- (v) ofrimit të sigurisë së njerëzve dhe pronës së tyre si dhe mbrojtjen e ambientit në territorin e Republikës së Kosovës;
- (vi) parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimit ndërkufitar në partneritet me agjencitë e tjera shtetërore për zbatimin e ligjit;
- (vii) parandalimit dhe zbulimit të të gjitha kërcënimeve tjera për sigurinë dhe rendin publik të lidhura me kufijtë shtetëror;
- (viii) parandalimit të lëvizjes së kundërligjshme të mallrave dhe pasurive të tundshme për të siguruar që të hyrat e akcizës doganore dhe tatimet të paguhen në mënyrë të duhur sic parashihet me ligj;
- (ix) parandalimit të lëvizjeve të mallrave dhe bagëtive të infektuara përmes kufirit shtetëror.

### **Neni 5**

#### **Organet që kryejnë menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror**

5.1 Menaxhimi i integruar dhe kontrolli i kufirit shtetëror është kryesisht kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

5.2 Detyrat e menaxhimit të integruar dhe kontrollit të kufirit shtetëror i kryen kryesisht policia kufitare, e ndihmuar nga agjencitë e tjera shtetërore relevante.

5.3 Policia kufitare është përgjegjëse për:

- (i) menaxhimin dhe kontrollin në Pikat e kalimit Kufitar;

- (ii) menxahimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen përgjatë Kufirit të Gjelbër;
- (iii) menxahimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen përgjatë Kufirit të Kaltër;
- (iv) menxahimin dhe kontrollin brenda Republikës së Kosovës lidhur me çështjet kufitare;
- (v) lëshimin e dokumenteve të përkohshme të udhëtimit siç përcaktohet nga Ministria e Punëve të Brendshme;
- (vi) sigurinë në aeroportet ndërkombëtare në bashkëpunim me operatorin e aeroportit dhe autoritetet relevante të autorizuar;
- (vii) parandalimin e akteve terroriste në partneritet me të gjitha agjencitë për zbatimin e ligjit;
- (viii) përcaktimin e së drejtës së çdo personi që dëshiron të hyjë apo të lëshojë Kosovën lidhur me kërkesat për viza dhe hyrje.
- (ix) mbylljen e përkohshme të kufijve, sipas vendimit ministror.
- (x) dhënien e autorizimit të përkohshëm për të kaluar Kufirin e Gjelbër dhe të Kaltër sipas vendimit.

## **Neni 6**

### **Lehtësimi i menxhimit të integruar dhe kontrollit të kufirit shtetëror**

6.1 Për zbatim të këtij ligji, Autoritetet Kompetente autorizohen të vendosin shenjat me paralajmërim dhe vërejtje të tjera, apo të përdorin mjete teknike dhe qen shërbimi për kryerjen e menxhimit të integruar, kontrollit të kufirit, si dhe të vendosin pengesa për të parandaluar kalimin e paligjshëm të kufirit.

6.2 Mirëmbajtja e shenjave dhe vërejtjeve të tjera sipas këtij neni, është përgjegjësi e Autoriteteve Kompetente.

6.3 Zyrtarët e Autorizuar lejohen të lëvizin në këmbë ose me automjet në pronat që ndodhen në zonën kufitare apo në afërsi të zonës kufitare në përputhje me ligjin në fuqi, kur kjo është e nevojshme për të kryer kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, pavarësisht nga dëshira e pronarit, i cili duhet të informohet, kurdo që të jetë e mundur para fillimit të kryerjes së aktivitetit në pronën e tij. Ai/ajo, duhet të informohet pas aktivitetit në secilin rast përveç nëse kjo mundë të rrezikojë operacionin policor të kontrollit kufitar.

6.4 Aktiviteti i Autoriteteve Kompetente në pronat që ndodhen në vijën kufitare, apo në afërsi të vijës kufitare, ushtrohet në atë mënyrë për të reduktuar deri në maksimumin e mundshëm, ndërhyrjen në sferën e jetës private të pronarit dhe dëmeve në pronë dhe nuk duhet të jetë jo proporcionale me qëllimin që kërkohet të arrihet.

6.5 Pronarët, marrësit me qira apo shfrytëzuesit e pronave pranë vijës së kufirit janë të obliguar t'u lejojnë Autoriteteve Kompetente kalim pa pengesë, me qëllim që të kryejnë rregullisht vëzhgimin e kufirit, kryerjen e punimeve, si dhe mirëmbajtjen e shenjat kufitare përgjatë kufirit.

## **KREU II**

## **VIJA KUFITARE**

### **Neni 7**

#### **Shënjimi i vijës kufitare**

7.1 Qeveria e Republikës së Kosovës emëron anëtarët e delegacionit për komisionet ndërshtetërore për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufijve shtetëror të vendosur në bazë të marrëveshjeve ekzistuese ndërkombëtare.

7.2 Nëse shtrirja e vijës kufitare nuk është e dukshme, afërsia e vijës kufitare duhet të shënjohet në rrugë dhe lidhjet tjera komunikuese me shenja paralajmëruese, barriera apo vërejtje të tjera të përshtatshme, të cilat tërheqin vëmendjen mbi afërsinë e vijës kufitare të shtetit, ku është nevoja.

### **Neni 8**

#### **Dukshmëria e vijës kufitare dhe ndalimi i veprimeve përgjatë vijës kufitare**

8.1 Me qëllim të sigurimit të dukshmërisë së vijës së kufirit, autoritetet kompetente mund të ndalojnë ndërtimin e objekteve, mbjelljen ose kultivimin e produkteve bujqësore, drurëve ose pemëve tjera përgjatë vijës së kufirit.

8.2 Nëse si pasojë e këtij vendimi u shkaktohet dëm personave fizikë ose juridikë, ata kanë të drejtën e kompensimit ashtu siç është definuar me akte nën ligjore.

8.3 Autoritetet Kompetente, për shkaqe sigurie kanë të drejtë që të ndalojnë lundrimin, peshkimin, kalimin apo praninë e avionëve, pajisjeve të tjera fluturuese dhe lëvizëse përgjatë vijës së kufirit.

### **Neni 9**

#### **Rregullimi i zonës përgjatë vijës kufitare**

Miratimi i Planifikimit Hapësinor të Komunës nëpërmjet të cilit rregullohet territori që shtrihet deri në 50 (pesëdhjetë) metra larg vijës së kufirit, kërkon miratimin nga Ministria e Punëve të Brendshme

### **Neni 10**

#### **Incidentet kufitare**

Në rastet kur ndodh ndonjë incident kufitar, Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zgjidhjen e tij.

## **KREU III**

## **KALIMI I KUFIRIT SHETËTOR DHE PIKAT E KALIMIT KUFITAR**

### **Neni 11**

#### **Kalimi i kufirit shtetëror**

11.1 Kufiri shtetëror, mund të kalohet vetëm në pikat identifikuar zyrtarisht të kalimit kufitar.

11.2 Në rast të ndonjë fuqie madhore, ose të përcaktuar nga marrëveshjet ndërkombëtare, kufiri mund të kalohet kurdoherë dhe në çfarëdo vendi.

11.3 Personat që kalojnë kufirin për shkaqe të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, menjëherë duhet të lajmërojnë policinë kufitare.

### **Neni 12**

#### **Trafiku Ajror transitor**

Personat të cilët kalojnë kufijtë shtetëror përmes trafikut transit ajror nuk i nënshtrohen kontrollit kufitar nëse nuk dalin nga aeroplani ose nëse qëndrojnë në zonën e identifikuar të transitit.

### **Neni 13**

#### **Përcaktimi i pikave të kalimit kufitar**

Pikat e kalimit kufitarë përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

### **Neni 14**

#### **Përcaktimi i pikave të përkohshme të kalimit kufitar për grupet specifike të personave**

Qeveria e Republikës së Kosovës mund të krijojë pika të përkohshme të kalimit kufitar për personat e emëruar individualisht ose grupe të personave, në konsultim me shtetin relevant fqinj.

### **Neni 15**

#### **Rregullimi i pikave të kalimit kufitar**

15.1 Operatorët e aeroporteve dhe stacioneve hekurudhore ofrojnë lehtësira të përshtatshme dhe ndërmarrin masa organizative të domosdoshme për të siguruar që menaxhimi i integruar dhe kontrolli i kufirit shtetëror është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

15.2 Operatorët e aeroporteve dhe stacioneve të hekurudhës i ofrojnë zyrtareve të autorizuar me qëllim të kryerjes së detyrave të tyre të sigurisë këto shërbime pa pagesë: a) hapësira dhe

zyra të përshtatshme b) numër të mjaftueshëm të hapësirave të parkingut, c) qasje në objektet e tyre, d) transportin, e) informacionin me kohë mbi orarin, f) kohën e fluturimeve dhe të gjitha lëvizjet aktuale të trafikut.

### **Neni 16**

#### **Zona e pikës së kalimit kufitar**

16.1 Të gjitha pikave të kalimit kufitar, përveç pikave të përkohshme të kalimit kufitar, ju ofrohet zonë e kalimit kufitar e cila është e përshtatshme për zhvillimin e kontrollit kufitar. Kjo përfshin hapësirat për trafik efektiv dhe të sigurve dhe zbatim të kontrollit të pikës kufitare.

16.2 Zona e kalimit të pikës kufitare për trafikun hekurudhor përfshinë, binarët hekurudhor dhe tokën përkatëse nga vija kufitare deri te vendkalimi kufitar.

16.3 Qeveria e Republikës së Kosovës përcakton të gjitha zonat e kalimit kufitar.

### **Neni 17**

#### **Shënjimi i pikës së kalimit kufitar dhe zonës së saj**

17.1 Pika e kalimit kufitar dhe zona e kalimit kufitar do të shënohen me shenja paralajmëruese dhe plotësuese.

17.2 Forma, përmbajtja dhe mënyra e vendosjes së shenjave paralajmëruese dhe plotësuese përcaktohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, në marrëveshje me Ministrinë e Transportit Postës dhe Telekomunikacionit.

### **Neni 18**

#### **Zona e Kontrollit kufitar**

18.1 Menaxhimi dhe kontrolli kufitar ushtrohet nga zyrtarët e autorizuar në pikat e kalimit kufitar.

18.2 Në rast se personi kapet duke kaluar kufirin shtetëror në mënyrë të paligjshme, policia kufitare e kryen kontrollin kufitar në vendin ku personi është gjetur.

18.3 Nëse përcaktohet me marrëveshje ndërkombëtare, menaxhimi dhe kontrolli kufitar mund të kryhet gjatë udhëtimit me tren i cili kalon kufirin shtetëror.

### **Neni 19**

#### **Obligimi i udhëtarëve dhe personave tjerë në zonën e kalimit kufitar**

Udhëtarët dhe personat e tjerë në zonën e kalimit kufitar u përmbahen udhëzimeve dhe urdhrave të lëshuara nga Zyrtarët e Autorizuar.

#### **Neni 20**

#### **Ndërtimi dhe vendosja e objekteve në zonën e kalimit kufitar**

Ndërtimi i objekteve në zonën e kalimit kufitar duhet të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

### **KREU IV**

#### **MENAXHIMI I INTEGRUAR DHE KONTROLLI KUFITAR**

#### **Neni 21**

#### **Menaxhimi i integruar dhe kontrolli kufitar**

21.1 Menaxhimi i integruar dhe kontrolli kufitar (MIK) përfshin masat për parandalimin e kalimeve të paligjshme të kufirit dhe veprimtarive të tjera të paligjshme të bëra nëpërmjet kufirit. Kjo përfshin ruajtjen, sigurinë dhe mbrojtjen e pikave të kalimit kufitar.

21.2 Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, Zyrtarët e Autorizuar mund të ndalojnë dhe arrestojnë përkohësisht personat, të cilët ju shmangen kontrolleve kufitare.

#### **Neni 22**

#### **Obligimi për t'ju nënshtrohet kontrollit kufitar**

22.1 Personat në zonat e kalimit kufitar të cilët synojnë të kalojnë apo kanë kaluar vijën kufitare duhet të prezantojnë dokumentin e vlefshëm të udhëtimit dhe të nënshtrohen kontrollit kufitar.

22.2 Personat që i nënshtrohen kontrollit kufitar duhet t'i tregojnë zyrtarit të autorizuar i cili bënë kontrollin çdo fakt relevant për kalimin e kufirit dhe veprojnë në pajtim me të gjitha udhëzimet ligjore të lëshuara nga zyrtarët e autorizuar.

22.3 Në rastet kur një person kërkon azil, atëherë zbatohen dispozitat për lëshimin e dokumentacionit të përkohshëm që i garantojnë të drejtën e hyrjes në Republikën e Kosovës të përcaktuar në Ligjin për Azil.

#### **Neni 23**

#### **Kontrolli Kufitar**



Zyrtarët e autorizuar të ngarkuar me menaxhimin e integruar dhe kontrollin kufitarë:

- (i) kërkojnë prezantimin e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit të nevojshëm për të kaluar kufirin shtetëror për persona dhe të mirave që i bartin me vete;
- (ii) shënojnë në dokumentin e udhëtimit çdo informatë në lidhje me rrethanat relevante për hyrje apo dalje nga shteti, përfshirë por duke mos u kufizuar me vulat në pasaportë;
- (iii) ndalojnë përkohësisht personat nëse është e domosdoshme siç e përcakton neni 26 i këtij ligji.
- (iv) të bëjë kontrollimin personal, kontrollimin e automjetit dhe/ose kontrollimin e gjësendeve (pajisjeve) që barten nga personi.

## **Neni 24**

### **Kontrollimi i personave, mallrave dhe mjeteve të transportit**

24.1 Kontrollimi i personave përfshinë:

- (i) verifikimin e dokumenteve të udhëtimit dhe të dhënave biometrike;
- (ii) verifikimin nëse ekziston apo jo një urdhër arresti i vlefshëm;
- (iii) kontrollimi fizik i personit duke ia marrë shenjat e gishtërinjve, të pëllëmbës, fotografimin si dhe kontrollime të tjera të tipareve fizike identifikuese.

24.2 Zyrtarët e autorizuar mund të kërkojnë nga personi që të tregojë se çka ai ose ajo ka me vete.

24.3 Zyrtarët e autorizuar mund të kontrollojnë personin dhe pasurinë çdo herë kur ekziston dyshimi për posedim të gjësendeve ose mallrave të paligjshme.

24.4 Kontrollimi i plotë i personave sipas këtij neni nuk përfshinë kontrollimin e kaviteteve trupore, përveç shikimit vizual të tyre. Megjithatë, shikimi vizual i anusit ose vagjinës së një personi duhet të kryhet vetëm me pëlqimin e personit, i cili duhet të informohet në lidhje me të drejtën e tij/saj për të mos e dhënë pëlqimin, dhe kontrollimi gjithmonë duhet bërë nga personi i gjinisë së njëjtë dhe në pajtim me dispozitat e nenit 243(3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Në rast se personi refuzon shikimin vizual të anusit ose të vagjinës, kjo mund të kryhet vetëm në pajtim me procedurat e përcaktuara me ligjin në fuqi dhe në një mënyrë të përshtatshme me standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me qëllim të ruajtjes së dinjitetit dhe të drejtave të individit. Në çfarëdo rasti, dispozitat dhe kufizimet e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës në lidhje me kontrollimin e një personi dhe në veçanti ato të parapara me nenet 204, 243, 245(5) dhe 245(6) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, aplikohen në procedurat e kontrollimit të plotë të personave siç parashihet me këtë ligj.

24.5 Kontrollimi i automjetit përfshinë inspektimin e jashtëm dhe të brendshëm vizual të automjetit dhe kontrollimin e plotë që përfshinë inspektimin e detajuar të të gjitha pjesëve të automjetit.

24.6 Zyrtarët e autorizuar mund të kryejnë kontrollimin e plotë të automjetit transportues dhe personave që gjenden në të.

24.7 Kontrollimi i mallrave përbën kontrollimin e objekteve dhe të sendeve, të cilat personi i cili ka për qëllim ta kalojë kufirin shtetëror me vete ose në automjet.

24.8 Nëse gjatë kontrollimit të personave, mallrave ose automjetit, zyrtarët e autorizuar gjejnë mallra të cilat mund të konfiskohen përkohësisht në pajtim me ligjet në fuqi, apo mallra të cilat janë relevante për procedurën penale, zyrtarët veprojnë në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi duke përfshirë por duke mos u kufizuar në Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Policinë.

### **Neni 25**

#### **E drejta për të qenë i pranishëm**

Pronari ose shfrytëzuesi i automjetit dhe pronari ose poseduesi i mallrave ka të drejtë që të jetë i pranishëm gjatë çfarëdo kontrollimi ose bastisje.

### **Neni 26**

#### **Arrestimi i përkohshëm, ndalimi i përkohshëm dhe ndalimi policor**

26.1 Zyrtarët e autorizuar mund të përkohësisht të ndalojnë dhe arrestojnë personin, nëse ai\ ajo:

(i) synon të kalojë ose ka kaluar vijën kufitare dhe ka dyshim të bazuar se ky person ka kaluar ilegalisht kufirin shtetëror;

(ii) është person i huaj i cili nuk i përmbushë kushtet për hyrje dhe/ose për qëndrim në Republikën Kosovës por që për shkaqe të arsyeshme, nuk mund të largohet menjëherë nga Republika e Kosovës.

26.2 Ndalimi i përkohshëm në asnjë rast nuk duhet t'i tejkalojë gjashtë orë. Nëse ndalimi i përkohshëm nuk bëhet nga zyrtari i policisë, personi menjëherë duhet t'i dorëzohet policisë. Pastaj, policia duhet t'i ndërmerr veprimet adekuate në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

26.3 Personi i ndalur ose i arrestuar përkohësisht do të informohet menjëherë për arsyet e masës së ndërmarrë dhe për të drejtat e tij/saj; nëse kohëzgjatja e masës i tejkalon gjashtë orë, personi informohet me shkrim për arsyet e masës së ndërmarrë. Personi do të informohet menjëherë në gjuhën të cilën ai e kupton, për arsyet e arrestimit dhe të drejtat e tij; nëse personi është shtetas i huaj i cili nuk e kupton njërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë, atij/asaj i sigurohet ndihma pa pagesë e përkthyesit si dhe ka të drejtë të thërrasë ose kontaktojë përfaqësuesin e tij/saj diplomatik në Republikën e Kosovës.

26.4 Në rast se është bërë kërkesë për azil, rasti do të trajtohet në përputhje me Ligjin mbi Azilin.

26.5 Personi i arrestuar ka të drejtë të parashtrijë ankesë kundër vendimit mbi ndalimin ose arrestimin e përkohshëm në gjykatën kompetente.

26.6 Gjykata kompetente do të vendosë për ankesën brenda 48 orëve nga momenti i parashtrimit të saj.

## **Neni 27**

### **Lehtësimi i pjesshëm i menaxhimit të integruar dhe kontrollit kufitar**

27.1 Kur menaxhimi i integruar dhe kontrolli kufitar nuk mund të kryhet plotësisht, për shkak të arsyeve organizative ose mungesës së kapaciteteve të personelit të cilat shkaktojnë vonesa të papranueshme në kalimin kufitar, zyrtarët e autorizuar përgjegjës mund që përkohësisht të urdhërojnë kontrollin e lehtësuar kufitar.

27.2 Në rastet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni, zyrtarët e autorizuar përgjegjës do t'i përcaktojnë objektivat prioritare të kontrollit të cilat duhet t'i adaptohen situatës specifike për të siguruar standardet më të larta të mundshme të kontrollit kufitar në rrethana përjashtuese.

27.3 Në përcaktimin e objektivave prioritare të menaxhimit të integruar dhe kontrollit kufitar, kontrollimet hyrëse në shtet kanë përparësi ndaj kontrollimeve dalëse nga shteti përveç nëse rrethanat e kërkojnë ndryshe.

27.4 Në pikat e kalimit kufitar ku trafiku është i rrallë, Ministria e Punëve të Brendshme mund të urdhërojë që menaxhimi dhe kontrollimet kufitare të kryhen nga patrullat policore.

## **KREU V**

### **MASAT E AUTORITETEVE KOMPETENTE NË BRENDI TË SHITIT**

## **Neni 28**

### **Masat në brendi të shtetit**

Në përputhje me këtë ligj, aktivitetet për kontrollin kufitar mund të kryhen në mbarë Republikën e Kosovës. Me qëllim të pengimit të trafikimit me qenie njerëzore, kontrabandës së emigrantëve, kalimeve të paligjshme të kufirit dhe për të siguruar kontrollin e të huajve, zyrtarët e autorizuar:

(i) kontrollojnë dhe zbatojnë masa adekuate me qëllim të zbulimit të hyrjes dhe qëndrimit të paligjshëm të shtetasve dhe të personave të huaj në Republikën e Kosovës.

(ii) kontrollojnë personat, sendet dhe automjetet në rrugë jashtë zonave të kalimit kufitar.

## **KREU VI**

### **BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

#### **Neni 29**

##### **Agjencitë e huaja të sigurisë**

29.1 Hyrja në Republikën e Kosovës mund të lejohet për pjesëtarët e uniformuar të agjencive të huaja të sigurisë, të cilët bartin armë dhe ngasin automjete të shënuara.

29.2 Leja për hyrjen e pjesëtarëve të organeve të huaja të sigurisë në territorin e Republikës së Kosovës lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

29.3 Leja mund të përmbajë kushte të veçanta për hyrje.

29.4 Në kushte të reciprocitetit, pjesëtarët e organeve të huaja të sigurisë që janë në kuadër të delegacionit zyrtar në vizitë zyrtare mund të hyjnë në Republikën e Kosovës, të bartin uniformat dhe armët e tyre personale.

29.5 Prestarët e organeve të huaja të sigurisë mund të sjellin dhe të mbajnë armë me tytë të shkurtër dhe municionin përcjellës në Republikën e Kosovës me lejen e Mistrisë së Punëve të Brendshme.

#### **Neni 30**

##### **Bashkëpunimi me organet e huaja të sigurisë**

Zyrtarët e shteteve të huaja mund të hyjnë në Republikën e Kosovës dhe të bëjnë kontrollimin e kufirit shtetëror të përcaktuar me marrëveshje ndërkombëtare; nën të njëjtat kushte, zyrtarët e autorizuar të Republikës së Kosovës mund gjithashtu t'i kryejnë detyrat e tyre jashtë Republikës së Kosovës.

#### **Neni 31**

##### **Zyrtarët ndërlidhës**

Me marrëveshje dypalëshe, Qeveria e Republikës së Kosovës mund të këmbëjë zyrtarë ndërlidhës me shtete tjera, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit në fushën e menaxhimit të integruar dhe kontrollit kufitar dhe për të siguruar qarkullimin e informatave.

## **KREU VII**

### **MBLEDHJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE DËSHMIVE**

#### **Neni 32**

##### **Mjetet automatike fotografike dhe incizuese**

32.1 Autoritetet kompetente mund të instalojnë mjete automatike fotografike dhe incizuese në zonat e kalimit kufitar dhe zonat tjera përgjatë kufirit shtetëror.

32.2 Mjetet automatike fotografike dhe incizuese të instaluar në zonat e kalimit kufitar do të instalohen në atë mënyrë që të jenë të dukshme përveç në rastet kur vëzhgimi i fshehtë konsiderohet të jetë i nevojshëm. Kur përdoren mjetet e fshehta, zyrtarët e autorizuar do të informojnë hierarkinë komanduese të Policisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

32.3 Nëse të dhënat personale janë incizuar, incizimet do të shkatërrohen brenda një viti, përveç nëse ato incizime nevojiten për ndjekjen e ndonjë vepre penale.

### **Neni 33**

#### **Mbledhja automatike e të dhënave**

33.1 Autoritetet Kompetente mund të mbledhin të dhëna personale t'i ruajnë të dhënat e mbledhura të personave të cilët i nënshtrohen kontrollit kufitar; për këtë qëllim mund të shfrytëzohen të gjitha mjetet teknike adekuate.

33.2 Gjatë kryerjes së kontrollit dhe menaxhimit kufitar, autoritetet kompetente mund t'i shfrytëzojnë edhe të dhënat e ruajtura në bazën e të dhënave të krijuar për mbledhjen e të dhënave dhe dëshmive për vepra penale.

### **Neni 34**

#### **Evidencat**

Për të siguruar menaxhimin dhe kontrollin efektiv të kufirit shtetëror, zyrtarët e autorizuar mund të shënojnë evidencat e:

- (i) personave që i nënshtrohen kontrollit kufitar;
- (ii) evidencat e personave që i janë nënshtuar procedurës së identifikimit në pajtim me nenin 24 të këtij ligji;
- (iii) hyrjeve në Republikën e Kosovës të pjesëtarëve të shërbimeve të sigurisë me uniformë, dhe automjete zyrtare
- (iv) personave të cilëve u është dhënë kartelet identiteti për lëvizje të lira në zonën e kalimit kufitar apo për lëvizje të lira përtej kufirit;
- (v) personave që kanë shkëlur rregullat për kalimin e kufirit shtetëror;
- (vi) personave në gjueti ose peshkim në afërsi të vijës së kufirit.

### **Neni 35**

#### **Të dhënat personale**

Për qëllimet e saktësuara në këtë ligj zyrtarët e autorizuar mbledhin, ruajnë dhe përdorin të dhënat personale në përputhje me ligjet në fuqi, instrumentet ndërkombëtare relevante dhe me

standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me qëllim të mbrojtjes së individëve nga çfarëdo shkelje e të drejtave të tyre ligjore lidhur me konfidencialitetin ose të drejtën ligjore për jetë private.

## **KREU VIII**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 36 Gjobat**

36.1 Zyrtarët e autorizuar do t'u shqiptojnë dënime individëve dhe personave juridik që shkelin dispozitat e këtij ligji.

36.2 Lloji i shkeljes dhe lartësia e gjobës përcaktohet me akt nënligjor.

#### **Neni 37 Zbatimi**

Brenda 6 (gjashtë) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria e Republikës së Kosovës, nxjerre akte nënligjore për zbatimin e plote të këtij ligji.

#### **Neni 38 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-065  
21 maj 2008**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**